



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 741/3 Prot

Tiranë, më 26.10.2021

V E N D I M

Nr.129, datë 26.10.2021

Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit, në Bashkinë Kavajë, filluar në bazë të informacionit të përcjellë me kërkesën nr. 741 prot., datë 15.07.2021, paraqitur prej nëpunësit civil ***.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 741 prot., datë 15.07.2021, nëpunësi ***** , ka parashtruar pretendime për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së veprimit administrativ të transferimit të përhershëm, për shkak të ristrukturimit dhe riorganizimit të institucionit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të hetimit administrativ, konstatohet se nëpunësi ***** është nëpunës civil i konfirmuar në pozicionin “Drejtore në Drejtorinë e të Ardhurave dhe Menaxhimit të Borxhit”, në Bashkinë e Kavajës.

Me miratimin e strukturës së re të institucionit, me vendimin nr. 1, datë 05.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, pozicioni “Drejtore në Drejtorinë e të Ardhurave dhe

Menaxhimit të Borxhit” është shkurtuar, duke u organizuar në nivel sektori, me emërtesën “*Spektori i Planifikimit të të Ardhurave, Mbledhjes së borxhit, Rakordimit të taksave dhe Apelimit*”, i përfshirë në Drejtorinë e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit.

Bazuar në sa më sipër, Kryetari i Bashkisë, me aktin nr. 13, datë 05.01.2021 “*Urdhër për transferim*”, ka vendosur kalimin e nëpunësit në fjalë në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të të Ardhurave, Mbledhjes së Borxhit, Rakordimit të Taksave dhe Apelimit*”.

Mbi bazën e një ankese të mëparshme (nr. 55/3 prot., datë 28.1.2021) të nëpunësit ***** , Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka verifikuar procesin e mësipërm administrativ dhe ka konstatuar në atë rast se akti i transferimit nr. 13, datë 05.01.2021 “*Urdhër për transferim*”, i Kryetarit të Bashkisë, ishte absolutisht i pavlefshëm pasi nuk ishin respektuar rregullat e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil në kryerjen e ristrukturimit dhe për këtë arsye, nëpërmjet vendimit nr. 63, datë 02.06.2021 “*Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit, në Bashkinë Kavajë, filluar në bazë të informacionit të përcjellë me kërkesën nr. 55/3 prot., datë 28.1.2021, paraqitur prej nëpunësit civil ******”, ka kërkuar anulimin e urdhrit nr. 13, dt. 05.01.2021 “*Për transferim*”, duke urdhëruar njëkohësisht përsëritjen e procesit të ristrukturimit, në respektim të rregullave të përcaktuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndyshuar dhe vendimit nr. 125, dt. 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, duke parë edhe mundësinë e sistemimit të nëpunësit, në një pozicion të lirë pune, të kategorisë që i përkiste pozicionit të tij të mëparshëm (nivele i mesëm drejtues).

Në zbatim të vendimit të mësipërm të Komisionerit, me aktin nr. 13, datë 14.06.2021, të njësisë së burimeve njerëzore është ngritur Komisioni i Ristrukturimit, i cili, me aktin nr.1850 prot., datë 25.06.2021 “*Njoftim mbi fillimin e procedurës së ristrukturimit të Bashkisë Kavajë*” ka njoftuar nëpunësin ***** për fillimin e procedurës së ristrukturimit. Në vijim, me aktin nr. 14/5 prot., datë 01.07.2021, Komisioni i Ristrukturimit, pasi ka konstatuar se pozicioni i tij i mëparshëm i punës “*Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave dhe Menaxhimit të Borxhit*” është suprimuar dhe ristrukturuar, ka propozuar që marrëdhënia në shërbimin civil për këtë nëpunës, në pamundësi sistemimi në një pozicion tjetër, të nivelit të mesëm drejtues, të vazhdojë në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Planifikimit të të Ardhurave, Mbledhjes së Borxhit, Rakordimit të Taksave dhe Apelimit*”.

Duke analizuar veprimet administrative dhe aktet si më sipër, konstatohet se nga pikëpamja formale, vendimi nr. 63, datë 02.06.2021 i Komisionerit është zbatuar, dhe njësia përgjegjëse bashkë me Komisionin e Ristrukturimit, kanë mbajtur parasysh kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, për institutin e ristrukturimit. Por, në përmbajtje të procesverbalit nr. 14/5 dt. 01.07.2021, të Komisionit të Ristrukturimit, nuk rezulton të jenë bërë përpjekje konkrete, për zbatimin e detyrës së Komisionerit, lënë në pikën 4, të vendimit

të tij, për të vlerësuar mundësinë e sistemimit të nëpunësit ***** në një pozicion tjetër të nivelit të mesëm drejtues, në të cilin ai ishte i konfirmuar, por është mjaftuar vetëm me shprehje të përgjithshme. Në aktin e mësipërm, nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me përpjekjet e bëra për verifikimin e faktit, nëse ka pozicione të tjera të lira, të nivelit të mesëm drejtues në bashki dhe nëse i plotëson apo jo kushtet nëpunësi në fjalë, për atë/ato pozicione.

Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ të kryer, është konstatuar se pozicionin “*Drejtor i Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit*”, i krijuar pas rristurimit të institucionit, të cilit i kanë kaluar një pjesë e kompetencave të drejtorisë ku nëpunësi në fjalë ka qenë “*Drejtor*”, e mban punonjësja ***** , e emëruar me urdhrin nr. 102, datë 27.08.2021, të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, pa respektuar ndonjë procedurë konkurrimi për praninë në shërbimin civil.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në konkluzionin se, mosrespektimi i dispozitave ligjore të sipërcituara, bën që Urdhri nr. 103, datë 27.08.2019, i nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë, për emërimin e nëpunëses ***** , bazuar në shkronjën “i”, të pikës “a”, të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë*”, të jetë një akt absolutisht i pavlefshëm dhe si i tillë, në bazë të neneve 110, pika 1, ai konsiderohet se nuk ekziston.

Duke mbajtur parasysh se, emërimi në shërbimin civil kryhet vetëm nëpërmjet procedurave të konkurrimit, për rastin në fjalë duhet të merren masa për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe pozicioni “*Drejtor i Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit*”, duhet të konsiderohet i lirë në kuptim të ligjit dhe t’i vihet në dispozicion Komisionit të Rristurimit, për të vlerësuar mundësinë e sistemimit në atë pozicion, të nëpunësit *****.

Në të njëjtën mënyrë duhet të veprohet, edhe nëse konstatohet ndonjë pozicion tjetër i lirë në kuptim të ligjit, duke vlerësuar nëse nëpunësi në fjalë i plotëson apo jo kërkesat për atë pozicion pune dhe vetëm në rast se sistemimi i tij në këtë pozicion do të jetë i pamundur, për ndonjë shkak të arsyeshëm apo të ligjshëm (*si mungesa e arsimit të kërkuar, vjetërsia e pamjaftueshme në punë, etj.*), ashtu siç është cituar në vendimin nr. 63, datë 02.06.2021, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, atëherë mund të ofrohet një pozicion i një kategorie më të ulët dhe, në rast mospranimit të pozicionit të ofruar, të veprohet sipas pikave 7 e 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në nenin 90/2, të ligjit nr. 44/2015

“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkohet nga organi publik, Kryetari i Bashkisë Kavajë, që me një akt të ri me shkrim, të anulojë aktin administrativ nr. 103, datë 27.08.2019, për emërimin e nëpunëses *****, në pozicionin *“Drejtor i Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit”*, si një akt i paligjshëm.
2. Ky pozicion t’i vihet në dipozicion Komisionit të Ristrukturimit të ngritur me urdhrin nr. 13, datë 14.06.2021, të njësisë përgjegjëse, për të parë mundësinë e sistemimit në këtë pozicion, të nëpunësit civil të kategorisë së mesme drejtuese *****.
3. Komisioni i Ristrukturimit të vendosë korrigjimin e pjesshëm (*paragrafin e fundit*) të vendimit të tij propozues nr. 14/5, dt. 01.07.2021 dhe të rishqyrtojë çështjen për mundësinë e sistemimit të nëpunësit ***** në një pozicion të së njëjtës kategori me pozicionin që ai mbante para ristrukturimit, duke përfshirë këtu edhe pozicionin *“Drejtor i Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit”*.
4. Nëse detyra e mësipërme, për shkaqe të ligjshme nuk është e mundur të plotësohet, t’i ofrohet një pozicion tjetër në shërbimin civil dhe në rast mospranimi të veprohet sipas pikave 7 e 8, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Kreut II, të Vendimit nr. 125, dt. 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*.
5. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
6. Me kalimin e këtij afati, njësia e burimeve njerëzore të institucionit është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
7. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e përcaktuara në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në

administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

8. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Kavajë dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, Komisioni i Ristrukturimit dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha